HISTORIA POLITIKE E SHPËRBËRJES SË JUGOSLLAVISË

Isak **SHERIFI**[1]

PËRMBLEDHJE

Jugosllavia u krijua në fund të Luftës së Parë Botërore, kur territoret kroate, sllovene dhe boshnjake që kishin qenë pjesë e Perandorisë Austro-Hungareze u bashkuan me Mbretërinë Serbe. Vendi u shkatërrua nën pushtimin nazist gjatë Luftës së Dytë Botërore me krijimin e një shteti kroat të pavarur nazist, por u ribashkua në fund të luftës, kur forca partizane e Josip Broz Titos e dominuar nga komunistët e çliroi vendin. Arsyet e ndryshme për shpërbërjen e vendit varionin nga ndarjet kulturore dhe fetare midis grupeve etnike që përbënin kombin. Një luftë mes republikave si dhe konflikti serioz ndërkomunal do ta shoqërojë shpërbërjen dhe do të vazhdojë më pas deri sa dhuna do të jetë e patolerueshme. Sllobodan Millosheviç, president i Serbisë nga 1989, mori avantazhin e vakumit të krijuar nga një shtet qendror që po dobësohej dhe do të arijë të vendos brutalisht përdorimin e ultra nacionalizmit serb për të ndezur konfliktet në republikat e tjera dhe për të fituar legjitimitet në shtëpi. Milosheviqi kreu i Partisë Komuniste Serbe në maj të vitit 1987 do të mer pjesë në një takim partiak në provincën e dominuar nga shqiptarët në Kosovë, ai do të flas me protestuesit dhe dëgjoi ankesat e tyre për keqtrajtimin e shumicës shqiptare. Veprimet e tij u raportuan gjerësisht nga media masive jugosllave, duke transformuar Milosheviqin në simbolin e nacionalizmit serb. Efektet e vazhdueshme të demokratizimit në Evropën Lindore do të ndjehen edhe në Jugosllavi do të pasojnë zgjedhjet në Slloveni dhe Kroaci në vitin 1990. Sllovenia ishte e para që deklaroi "sovranitetin" në vitin 1990, duke lëshuar një deklaratë parlamentare se ligji slloven mori përparësi mbi ligjin jugosllav. Kroacia ndoqi të njëjtin hap në maj dhe në gusht, republika jugosllave e Bosnje-Hercegovinës gjithashtu u deklarua sovrane. Evropa ishte dëshmitare e luftimeve më të tmerrshme në territorin e saj që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore. Në 1998-1999, dhuna përsëri shpërtheu në Kosovë. Një fushatë bombarduese e NATO-s dhe sanksionet ekonomike detyruan regjimin e Millosheviçit të pranonte një forcë ndërkombëtare të mbajtjes së paqes nga NATO.

***Fjalët kyçe**: konflikti, sovraniteti, shpërbërja, konfliktet, nacionalizmi.*

1. HYRJE

Me rrënien e Murit të Berlinit në vitin 1989 do të hapet një kapitull i ri në shumë pjesë të Evropës e më së shumti atë të Ballkanit perëndimorë. Ky process do të jetë edhe pikënisja e krijimit të sistemit shumëpartiak. Me krijimin e partive të reja politike në Jugosllavi u krijuan shumë parti politike që synonin pavarësinë e tyre nga ish Federata. Ky proces nuk do të jetë i lehtë, do të ndiqet me përleshje të brendshme të etnive të ndryshme që jetonin në ish-republikat. Këto vende akoma po përballen me vështirësi të brendshme dhe divergjencat e vështirësitë nuk janë tejkaluar. Zhvillimi ekonomik dhe reciprociteti i brendshëm ndërmjet komuniteteve që jetojnë në

[1] *Universiteti i Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut, i.sherifi@hotmail.com isak.sherifi@unite.edu.mk*

këto republika janë në shënjestër. Poashtu këto procese janë një pikë kyçe për zgjedhjen përfundimtare të problemeve në këto treva sepse shumë nga tiparet e viteve të hershme janë evidente edhe sot në mënyrën se si elitat e brendshme zhvillojnë marrëveshjet e tyre politike, dhe mënyrën se si qytetarët reagojnë përmes zgjedhjeve të përfaqësuesve të tyre politik.

1.1 HISTORIKU I KRIJIMIT TË JUGOSLLAVISË

Pas përfundimit të Luftërave Ballkanike të vitit 1912-13, si dhe përfundimin e sundimit osman në Gadishullin Ballkanik edhe Austro-Hungaria u mund në Luftën e Parë Botërore kështu që do të shfaqet nevoja e mbajtjes së një konference. Konferenca e Paqes e Parisit nënvizoi një model të ri të kufijve shtetërorë në Ballkan- Mbretëria Jugosllave, e shpallur zyrtarisht në vitin 1929 e cila zgjati deri në Luftën e Dytë Botërore dhe kishte një popullsi prej rreth 24 milionë deri në vitin 1991. Jugosllavia Socialiste u formua në vitin 1946, pasi Josip Broz Tito dhe partizanët e tij të udhëhequr nga komunistët kishin ndihmuar në çlirimin e vendit nga sundimi gjerman në 1944-45. Kjo Jugosllavi e dytë mbulonte afërsisht të njëjtin territor, me shtimin e tokës së fituar nga Italia në Istria dhe Dalmaci. Për shaktërrimin e Jugosllavisë u dashtën vetëm pak vite. Udhëheqësi dhe lideri më i njohur komunist Tito do të jetë në krye të Federatës Jugosllave për pothuajse 35 vite. Ai së bashku me bashkëpunëtorët e tij do të arijë të mbajë të bashkuar Federatën Jugosllave dhe ta përforëcojë duke rritur kapacitetet ekonomike.

Bota perëndimore do ta përkrahë Titon për arsye se ai kishte shprehur pavarësinë e tij gjeopolitike nga sovjetikët, andaj edhe shpesh herë bëhej e shurdhër dhe e verbër ndaj politikës së tij. Pasardhësi i Stalinit Nikita Hrushov do të bëjë përpjekje të shumta për rikthimin e besimit tek Tito duke i ofruar ripranim të Jugosllavisë në Traktatin e Varshavës. Tito këtu me dinakëri do ti ikë këtij bashkëpunimi. Si faktor që shkaktuan pakënaqësi do të jenë ndryshimet e papërshtatshme kushtetuese. Mbretëria u zëvendësua nga një federatë prej gjashtë republikave të barabarta, si: Kroacia, Mali i Zi, Serbia, Sllovenia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia. Në Serbi, dy krahinat e Kosovës dhe Vojvodinës patën statusin autonom në mënyrë që të pranonin respektivisht interesat specifike të shqiptarëve dhe të hungarezëve.

1.2 FILLIMI I KRIZËS NË ISH JUGOSLLAVI

Periudha pas vitit 1966 do të karakterizohet me ringjalljen dhe nacionalizmin kroat lëvizje kjo që do të fillojë mes studentëve. Nga viti 1971 edhe në mes të anëtarëve të Partisë Komuniste do të fillojë të qarkullojnë propozimet për shkëputjen e Kroacisë. Titoja këtu do të veprojë me shtypjen dhe burgosjen e personave që morrë n pjesë e ndër ta edhe Franjo Tugjman. Vendet veriore të Jugosllavisë kishin edhe pakënaqësi shoqërore dhe vështirësi ekonomike, prandaj sllovenët dhe kroatët kundërshtonin planifikimin e centralizuar ekonomik. Ata parapëlqenin që të investonin në vendet e tyre për arsye se kishin industri të shë ndoshë dhe kishin të zhvilluar poashtu edhe turizmin nga deti Adriatik. Pas vdekjes së Titos nga vitet 1980, secila nga republikat dhe krahinat autonome ishin shtet brenda shtetit, kishte shumë dallime dhe humnera në mes të kombeve sa vinte e thellohej.

Pas separatizmit kroat do të del në pah edhe nacionalizmi serb, megjithë se etnitë e tjera besonin se serbët kishin ndikim më të madh në federatë, serbët këmbëngulnin se sistemi jugosllav i vë

ata në një pozitë jo të favorshme.[23] Në anën tjetër situata në rajonin e Kosovës për arsye të rëndësisë mitike për serbët ishte shumë e rëndë . Do të mjaftonin protestat studentore për arsye të kushteve të këqija që situata të del jashtë kontrolle dhe të ndërhyjë policia serbe kundër shqiptarëve. Nga viti 1985 Akademia serbe e Shkencave do të hartojë memorandum ku do të kritikojë Titon dhe politikat e tij antiserbe. Sipas tyre për 30 vitet e komunizmit Serbia ka mbetur më e varfër se sa veriu i Jugosllavisë. Do të kritikohen edhe politikat e "gjenocidid" antiserb ku thuhej se shumica shqiptare po "shtyp" pakicën serbe në Kosovë. Akademia do të mbështet idenë e një shteti serb dhe kjo ide do të përkrahet fuqishëm nga Sllobodan Millosheviqi i cili ishte produkt i sistemit komunist jugosllav. Milosheviqi do të bëhet kryetar i Lidhjes Komuniste të Serbisë dhe në vitin 1987 do të mbajë fjalimin "patriotik" proserb në Fushë Kosovë me të cilin do të fitojë mbështetjen e gjërë popullore dhe kështu do të fillojë të pastrojë partinë nga rivalët, si dhe do të "kujdeset" edhe për mjetet e informimit publik. Në janar të vitit 1990 Lidhja Komuniste u nda nga qarqet nacionaliste. Në atë kohë policia serbe rriti zemërimin e shqiptarëve në Kosovë. Armata Jugosllave ndërhyri për të rivendosur pushtetin ushtarak. Këto episoda të dhunshme prej policisë Jugosllave nxitën ndjenjat nacionaliste për ndarje. Në pranverë të vitit 1990 Sllovenia dhe Kroacia ndërmorën hapa konkret drejt ndarjes.

Në Prill koalicioni slloven i qendrës së djathtë fitoi zgjedhjet dhe filloi ndërtimin e një kushtetute që të jepte të drejtën për tu nda nga Jugosllavia. Në Kroaci Tugjman themeloi BDK (Bashkimin Demokrat Kroat), një parti nacionaliste e cila i fitoi zgjedhjet në prill. Në Serbi referdendumi i 1 qershorit 1990 i dha të drejtë Serbisë që të hiqte autonominë Vojvodinëes dhe Kosovës. Referendumi në Serbi bëri që Sllovenia dhe Kroacia të vendosnin për tu ndarë nga Federata. Në këtë mënyrë hendeku mes blloqeve nacionaliste po rritej. Në këtë moment Milosheviqi, udhëheqësi serb deklaroi se nëse Jugosllavia do të ndahej atëherë të gjithë serbët kudo që jetojnë do të bashkoheshin në një etni të vetme politike. Milosheviqi gjithashtu shtypi edhe revoltat shqiptare. 4 Përplasjet e para jashtë Kosovës kur filluan për herë të parë pati disa të vdekur. Në Maj 1991 një kroat duhej të bëhej president i Jugosllavisë në përputhje me sistemin e rotacionit të presidencës jugosllave por serbët refuzuan të pranojnë një president Kroat. Rruga konstitucionale për të gjetur një zgjedhje brenda Federatës dështoi. Kështu që në qershor Sllovenia dhe Kroacia shpallën pavarësinë.

Në mars 1992, lufta do të shpërndahet nga Kroacia në Bosnjë. Kjo ish Republikë jugosllave u nda gjatë luftës ndërmjet etnive. Në mars 1992 një shumicë boshnjake votoi për pavarësinë e vendit me plebishit, por grupet tjera etnike kundërshtuan. Në Gjenevë të Zvicrës procesi i bisedimeve zuri vend me mediatorët anglo-amerikanë Vance dhe Owen. Plani i tyre ndante Bosnjën në etni të ndryshme dhe do ti jepte fund luftës, por ky plan u kritikua ashpër nga presidenti Amerikan Klinton i cili u distancua nga ky plan. Në këto 40% e serbëve kontrollonin më shumë se 70% të Bosnjës. Nën presionin ndërkombëtarë udhëheqësi i serbëve Karaxhiq pranoi planin e coptimit me 52%. Duke qenë nën presionin ndërkombëtarë dhe në një situatë ekonomike të vështirë Milosheviqi dëshironte fundin e konfliktit në Bosnjë. Ndërkohë boshnjakët muslimanë fillojnë të bëjnë median për vete opinionin publik të perëndimit dhe pak nga pak arritën të marrin ndihma nga Kombet e

[2] *Tafili, Eva "Tranzicioni politik në Evropën qendrore dhe lindore" Pegi, Tiranë 2008 faq.*

[4] *Lorry Bernard ;"Evropa Ballkanike nga 1945 deri në ditët tona " Dituria 2007 faq 256*

Bashkuara dhe armë me trafiqe për shkak të sanksioneve ekonomike.5 Derisa me Bosnjën konflikti do të jetë shumëi ashpër, me Maqedoninë do të ndahet shumë qetas dhe në mënyrë vëllazërore. Maqedonia ishte njëra nga shtetet e ish Jugosllavisë që fitoi autonominë në mënyrë të qetë e paqësore. Ushtria Jugosllave në bazë të marëveshjes për tërheqje paqësore u realizua pa ndonjë incident. Vlen të theksohet se edhe zgjedhjet e para pluraliste, shpallja e pavarësisë si dhe Kushtetuta e shtetit kaloi në mënyrë të qetë. Zgjedhjet e para parlamentare të vitit 1990 ishin edhe zgjedhjet e para shumpartiake në Republikën e Maqedonisë. Përbërja e parlamentit e dalë nga këto zgjedhje miratoi aktet themelore dhe ligjet kyçe për funksionimin e shtetit si deklarata për sovranitetin e Maqedonisë (1991), vendimin për mbajtjen e referendumit për shtet Sovran dhe të pavarur, kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, deklarata për njohje ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë. Me kushtetutën e vitit 1991 Republika e Maqedonisë definohet si shtet me sistem parlamentar të qeverisjes bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve. Nga vitet 1997-1999 në këtë periudhë konflikti u përqëndrua në Kosovë. Mbas më shumë se gjashtë vjetësh politikë paqeje te ndjekur prej udhëheqësit të moderuar të shqiptarëve Ibrahim Rugovës, procesi filloi të përkeqësohej. Masat represive qe u morën nga Beogradi pas dështimit në Bosnjë qenë të rënda. Të gjitha të drejtat konstitucionale dhe civile të shqiptarëve u suprimuan. Pati shumë të vrarë dhe dhunime në masë. Veprimi diplomatik i Rugovës dështoi së bashku me veprimet edukative të Milosheviqit. Ky ishte sinjali që Milosheviqi nuk kishte ndërmend të toleronte më tej shqiptarët. Milosheviqi mobilizoi minoritetin serb duke e armatosur dhe armata jugosllave filloi veprimet kundër shqiptarëve.

Mbas sanksioneve dhe rekomandimeve për tu tërhequr Këshilli i Sigurimit i OKB-së vendosi të mobilizonte NATO-n për sulme ajrore kundër Beogradit dhe bazave serbe në Kosovë në pranverë të vitit 1999. Ky veprim çoi në përfundimin e konfliktit. Trupat e Kombeve të Bashkuara u vendosën atje dhe filloi nga puna misioni civil i kësaj organizate. Viti 2003 shënon zhdukjen e Federatës Jugosllave nga harta politike e Ballkanit mbas 83 vjetësh të ekzistencës së saj. Federata e Jugosllavisë u zavendësua me një union të humbur, të quajtur thjeshtë Serbi- Mali i Zi. Ky lloj rregullimi i padefinuar qartësisht e përfundimisht u arrit kryesisht nën presionin politiko-diplomatik të Bashkimit Evropian.

1.3 PARTITË POLITIKE GJATË PERIUDHËS SË TRANZICIONIT

Ndryshimi më i shquar politik në të gjitha këto vende pas ndarjes së monopolit të partisë komuniste ishte shfaqja e partive politike dhe lëvizjet e gatshme për të konkurruar në arenën zgjedhore. Të gjithë shtetet post-komuniste ballkanike hoqën parësinë e partisë komuniste dhe mundësuan futjen e partive të reja brenda politikës. Rrënien e sistemit monist dhe vendosjen e pluralizmit politik në shtetin e atëhershëm të Jugosllavisë, të gjithë kombet do ta mirëpresin me shpresë dhe besim në ndryshimin pozitiv të së ardhmes së tyre, duke pasur parasysh represionin, ndjekjet, persekutimet, burgosjet, por edhe vrasjet që ata kishin përjetuar me dekada të tëra. Në Kroaci, lëvizja nacionaliste është udhëhequr nga Bashkimi Demokratik Kroat (HDZ), nën udhëheqjen e Franjo Tugjmanit. HDZ fitoi pushtetin në vitin 1990 për shprehjen e saj anti-komuniste dhe identitetin kroat. Ajo u pa si alternativa më serioze e socializmit ateist të

[5] *Glenny Misha,"Histori e Ballkanit" 1804-1999; Granada books Londër 2000 faq 644*

ish-komunistëve, ose Partia e Demokratike për Ndryshime (më vonë e quajtur Partia Social Demokratike SDP). Nga Blloku maqedonas partitë më të rëndësishme ishin: MAAK (Lëvizja për Aksion Gjithmaqedonas), ish LKM do të reformohet me emër të ri Partia për transformim Demokratik e më pas e njëjta parti do të ndryshojë emrin në Lidhja Social Demokrate LSDM. VMRO-DPMNE do të jetë partia e cila kishte synim bashkimin e të gjithë maqedonasve në një shtet. Partia e parë shqiptare që u themelua në hapësirën e ish-Jugosllavisë (në Kosovë) ishte Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), më 23 dhjetor 1989. Partia e parë politike që rreth vetes tuboi shqiptarët e Luginës së Preshevës ishte Partia e Veprimit Demokratik (PVD), e cila u themelua më 19 gusht 1990.

Shqiptarët e Maqedonisë formuan dy parti politike brenda një kohe të shkurtër: Partinë e Prosperitetit Demokratik, më 16 prill 1990, dhe Partinë Demokratike Popullore (PDP), më 23 qershor 1990. Edhe shqiptarët në Mal të Zi do të ndjekin shembullin e bashkëkombasve të tyre dhe më 9 shtator 1990 themeluan partinë e parë të tyre nacionale, me emrin Lidhja Demokratike në Mal të Zi (LD në MZ). Të gjitha kë to parti do të ndikojnë në afirmimin e vlerave demokratike edhe pse ky tranzicion politik si që u pa më lartë u përshkrua me ngjarje shumë dinamike. Megjithëse këto vende dolën nga konfliktet e përgjakshme me përjashtim të Maqedonisë e cila më vonë do të përfshihet nga një konflikt i brendshëm shqiptaro-maqedonas i cili do të ndërmjetësohet nga faktori politik shqiptarë dhe komuniteti ndërkombëtarë, gjë që rezultoi me marrëveshje ndërkombëtare, Marrëveshja e Ohrit, e cila jep garanci që partitë politike ta zbatojnë në tërësi dhe ta përshpejtojnë procesin e integrimit të Maqedonisë në institucionet Euro-Atlantike.

2. PËRFUNDIM

Problemet e shkaktuara në trevat e ish-Jugosllavisë që sollën deri tek shkatërrimi i saj do të sjellë deri në hapjen e një sërë problemesh të vjetra në tërë trevat Ballkanike. Konfliktet që sollën deri tek shpërbërja e RSF të Jugosllavisë kanë qenë të vështira si për popullatën atje poashtu edhe për bashkësinë ndërkombëtare për të cilën paraqiste një sfidë të vështirë. Menjëherë pas lindjes së shteteve të reja të pavarura do të shfaqet edhe problemi i tranzicionit apo kalimit nga socializmi në kapitalizëm. Të gjitha shtetet që dolën nga ky tranzicion mendonin dhe shpresonin se do të kenë një zhvillim të hovshëm qoftë ekonomik poashtu edhe politik. Në këtë fazë përpos Sllovenisë e cila nuk pati shumë pasoja për arsye të kohëzgjatjes së luftës atje Republikat tjera do të përballen me shumë vështirësi. Problemet më të vështira me të cilat do të ballafaqohen këto shtete do të jenë ato ekonomike dhe më pas problemet politike dhe mungesës së bashkepunimt të ndersjelltë rajonal për dalje nga krizat e njëpasnjëshme. Të gjitha këto shtete dëshirojnë integrimin euroatlantik ,inkuadrim në Nato dhe BE, mirëpo kanë hasur në vështirësi të shumta dhe prandaj ky proces duket të jetë i vështirë dhe për disa republika akoma larg.

3. Studime Mbështetëse

Aziri, E. (2004). *Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni.* Shkup: Logos-A.

Glenny, M. (2000). *Histori e Ballkanit-1804-1999* . Londër: Granata books.

Jasminka Udoviçki James Ridgeëay. (1998). *Makthi etnik i Jugosllavisë* . Neë York: Albin.

Lorry, B. (2007). *Evropa Ballkanike nga 1945 deri në ditët tona* . Tiranë: Dituria.

Maliqi, N. (2002). *Gjurmë politike.* Shkup: Maliqi N.

Murati, S. (2009). *Profile te diplomacise Europiane ne Ballkan.* Tirane: UET Press.

N.I. (1991). Duel ndërmjet Jugosllavëve dhe hungarezëve. *Bujku* , 10-21.

Ndrecaj, M. (2001). *87 vjet terror dhe gjenocid shtetërorë (1912-1999).* Prishtine.

Sherifi, I. (2016). *Dezintegrimi i Jugosllavisë.* Tetovë: Arbëria design.

Tafili, E. H. (2008). *Tranzicioni Politik ne Evropen qendrore dhe lindore.* Tirane: Pegi.